



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**  
**Sesioni Pranveror**

**Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor**

Mbledhja nr. **67**

Prishtinë, më 6.4.2010, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

**PROCESVERBAL**

nga mbledhja e Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Naser Rugova, Naim Maloku, Zulfi Merxha, Hestet Cakolli, Berat Luzha, Elheme Hetemi, Selvie Halimi, Myrvete Pantina, Ali Lajçi, Zef Morina.

Mungoi : Branislav Grbić.

Të ftuarit dhe pjesëmarrësit tjerë : Ministri Mahir Jaghillar dhe ministri Blerand Stavileci, zyrtar, bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar .

Nga stafi mbështetës i komisionit : Bajram Badivuku.

Mbledhjen e kryesoi **Naser Rugova**, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 16.3.2010,
3. Njoftimi nga ministri Yagcillar dhe Stavileci rreth progresit evropian,
4. Të ndryshme.

**1. Kryetari** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes, hapi mbledhjen për pikat e **rendit të ditës**, për të cilat nuk kishte vërejtje.

**2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 16.3.2010**

**Kryetari** konstatoi miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**3. Njoftimet nga dy ministrat për progresin evropian**

**Kryetari Naser Rugova** falënderoi për pjesëmarrje dhe përshëndeti dy ministrat duke uruar punë të mbarë ministrit posa të emëruar z. Stavilecit në ministrinë e Bujqësisë. Njëherit përshëndeti këshilltarin e komisionit z. Qazim Kukalaj duke falënderuar për këtë UNDP, KFOS-in dhe qeverinë Norvegjeze të cilat bashkërisht do të financojnë këtë këshilltar të komisionit. Para se të raportoi ministri bujqësisë kryetari bëri një uverturë të kërkesave të agjencisë evropiane rreth progresit evropian për shkak të postit posa të filluar nga ministri i

cili tanimë me siguri është njoftuar për rrjedhat aktuale. Një nga sfidat e para nga këto kërkesa, vazhdoi kryetari, është pse ministrat nuk raportojnë me shkrim çdo tre muaj në komisionin parlamentar, ndaj luti ministrin që këto kërkesa mos të përsëriten dhe rregullisht të raportohet nga kjo ministri, këto raporte pastaj do të dërgohen në shqyrtim përfundimtar në seancën plenare të veçantë. Sfida e parë është ligji i bujqësisë organike (ku organi përfaqësues mungon dhe mjetet financiare), pastaj ligji për verëra, etj.

**Ministri Stavileci** falënderoi dhe siguroi për një bashkëpunim në nivelin më të lartë me këtë komision. Lidhur me sfidat e progresit evropian tha se ligji për bujqësinë organike është në fazën përfundimtare të amendamentimit sipas rregullores së BE i cili shpejt do të dërgohet në parlament, njëherit është themeluar njësia për bujqësi organike dhe programi. Kjo vlen edhe sa i përket ligjit për verëra (në fund të çerekut të dytë të këtij viti) për të cilin janë hartuar UA përkatëse ( i numëroi disa), këtu ka vonesa për shkak të reformimit të fushave të rëndësishme si cilësia e kontrollit dhe standardet e etiketimit, ndërkaq për Pyjet tha se ligji për ndryshim plotësim tanimë është shpallur në gazetën zyrtare dhe priten rezultate konkrete pasi kompetencat do të kalojnë tek komunat dhe do të ketë masa të ashpra ndëshkimore për keqberësit. Udhërrëfyes tjetër në këtë ministri për pyje do të jetë edhe strategjia 10 vjeçare e ministrisë. Sfidë tjetër është pësimi i bujqësisë kosovare nga zotërimet e ngastrave të vogla të tokës, kontrolli i dobët i shfrytëzimit të tokave pjellore për ndërtim, vlerësimi dhe përcaktimi i çmimit të tokave bujqësore, vështirësitë e fermerëve për marrjen e kredive etj. Ndaj lidhur me këto vështirësi është hartuar projektligji për komasacionin e tokës bujqësore i cili është dërguar në Qeveri, ndërkaq strategjia për konsolidimin e tokës bujqësore është dërguar komisionit evropian për komente.

**Naim Maloku** falënderoj dhe pyeti rreth pyjeve a janë aftësuar komunat për të marr përgjegjësitë sipas ligjit më të ri që ka hy në fuqi, por pasi ministri ka filluar tani detyrën nuk kërkoi përgjigje por kërkoi që i njëjti të ndërmer hapat konkret në këtë drejtim duke vizituar komunat dhe përshpejtuar hapat në zbatimin e ligjit që ka hy në fuqi, por edhe hartimin e ligjit të ri deri në fund të vitit.

**Berat Luzha** gjithashtu uroi ministrin për detyrën e re dhe kërkoi që ligji i ri për pyje i premtuar nga ministria e bujqësisë, të hartohet më herët se dhjetori i këtij viti sepse ndryshim plotësimi i bërë (ligji i cili tani ka hy në fuqi) nuk i plotëson kushtet e duhura.

**Selvie Halimi** duke uruar punë të mbarë ministrit të ri gjithashtu kërkoi angazhim rreth pyjeve sipas ligjit në fuqi, në mënyrë që të përgatiten komunat sa më mirë.

Ministri dorëzoi raportin me shkrim.

**Ministri Yagcillar** përshëndeti ministrin Stavileci, ndërsa lidhur me sfidat në MMPH gjithashtu dorëzoi raportin me shkrim dhe shtoi se për vendbanimet joformale kjo ministri ka parapa masa për integrimin e këtyre vendbanimeve, është hartuar plani i veprimit, është hartuar drafti i parë i strategjisë dhe planit dhe identifikimin e këtyre vendbanimeve, ndërsa sa i përket masave për parandalim ligji për programet e veçanta të banimit tani është miratuar në parlament dhe prezantimi i udhëzuesit për banim social në komuna, gjithashtu do të shfrytëzohen përvojat nga Gjermania. Për kampin e romëve në Mitrovicë do të bashkëpunohet edhe me ministrinë për komunitete. Ligji për qendrën historike të Prizrenit dhe Hoçën e Madhe në aspektin politik janë çështje sensitive ku mungon komunikimi me kishën ortodokse por edhe me komunitetin lokal. Në fushën e cilësisë së ajrit ligji i ri është në procedurë e sipër si dhe është hartuar drafti i parë i strategjisë për cilësinë e ajrit. Krijimi i sistemit të rrjetit monitorues ka filluar dhe janë vendosur 5 stacione dhe një stacion mobil për cilësinë e ajrit. Rreth progresit në fushën e mbrojtjes së natyrës dhe transpozimit të direktivës së zogjve dhe habitateve këto dy direktiva janë transpozuar në ligjin e ri për mbrojtjen e natyrës të sivjetmë. VNM dhe VSM gjithashtu janë në procedurën e ndryshim plotësimi ndërsa rreth ndotjes industriale janë disa probleme me lejet integruese por të tejkalueshme. Themelimi i Bordit për mbrojtjen e mjedisit së shpejti do të dërgohet lista e finalizuar në Qeveri. Për rrezatime ligji është miratuar por pritet themelimi i agjencisë me bekimin e kryeministrit të Kosovës. Ligji për Ujërat është në hartim e sipër. Ligji për parqet poashtu do

të shpallë malet e Sharrit dhe Bjeshkët e Nemuna. Po punohet edhe në ndërtimet ilegale dhe për ligjin e ndërtimeve njëkohësisht.

**Naim Maloku** falënderoj për sqarime dhe rikujtoi ministrin se ZRRUM nuk ka udhëheqës momentalisht për çka Qeveria ka dërguar një propozim identik (për udhëheqës në këtë zyre) si në vitin e kaluar i cili është refuzuar nga seanca plenare, ndaj kërkoi nga ministri të parashikoi problemet lidhur me këtë çështje në seancën e radhës, ngase problemet me mbeturina janë një ndër problemet shumë alarmuese në Kosovë, çka u dëshmuar gjatë monitorimit të ligjit përkatës nga ky komision, ndërkaq Ligjin për banim e propozoi të jetë ligji i radhës për monitorim nga komisioni ngase e njëjta nuk zbatohet, sidomos sa i përket banesave kolektive. Ai kërkoi nga ministri që para se të mirët komisioni me këtë ligj, të shikoi rregullsinë e UA-ve të miratuara, a janë zbatuar të gjitha si duhet, të konsultohet me sektorët përkatës për këtë ligj etj, ndërsa për kampin e romëve në Mitrovicë japi mbështetjen personale për zgjidhjen e problemit duke kërkuar nëse ka nevojë edhe buxhet shtesë.

**Myrvete Pantina** kishte kërkesë për zbatimin e ligjeve ngase tanimë ka mjaft ligje të miratuara të cilët presin zbatimin sepse siç dihet mbrojtjen e mjedisit e kemi pikë të dobët. Në vazhdim i ceku disa ligje më aktuale (mbi kontrollin e CO2, Kosovën e re, ajrit etj).

**Berat Luzha** pyeti për Këshillin e Ujërave për çka ministri kërkoj falje që nuk sqaroi më herët dhe tha se ky këshillë funksionon por me ca vështirësi financiare, problemet MMPH-Parlament etj. Mbi të gjitha ai sugjeroi modelin nga Shqipëria të themelohet këshilli ndërministror që do të ishte më efikase, pasi të shqyrtohet nga Qeveria të shikohet çka është më mirë për Kosovë përkatësisht për ujëra (deputetët kërkuar azhurnim në këtë drejtim). Ministri vazhdoi me përgjigje tjera në pyetjet e parashtruara duke potencuar përzierjet e kompetencave me komuna në rend të parë. Lidhur me ZRRUM tha se kjo ministri nuk është i involvuar por nuk do të mungoi ndihmesa ashtu si kërkoi z. Maloku. Për Ligjin e banimit do të hartohen UA në vazhdim dhe do të bëhen vizitat rreth banesave kolektive, sidomos për kampin e romëve në Mitrovicë në bashkëpunim me ministrinë për komunitete por edhe me një pilot projekt për të cilin ende është duke u finalizuar.

Kryetari **Naser Rugova** falënderoi dhe angazhoi administratorin që të kompletoi shkresat për procedim të mëtejme në komisionin funksional.

#### **4. Të ndryshme**

Si sugjerim i vetëm në këtë pikë ishte të kontaktoi administratori i komisionit me përfaqësuesen e komisionit evropian Iva Stamenova rreth vizitës së komisionit në Belgjikë-Bruksel.

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 14,15.

Kryetari i Komisionit,  
**Naser Rugova**